



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 1850/3 Prot.

Tiranë, më 21/7/2012

Lënda: Rekomandim për Klinika –Mjekësore “Kristi”, Korçë.

REKOMANDIM

Nr. 18, datë 02/07/2012

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, Klinika –Mjekësore “Kristi”, Korçë,

KONSTATOVA

Më datë 07-08/06/2012, nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar inspektimi administrativ pranë kontrolluesit, Klinika –Mjekësore “Kristi”, Korçë, me cilësinë e kontrolluesit që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- **Ligjshmëria e përpunimit të të dhënave personale nga kontrolluesi “Medical Clinic-Kristi” Korçë, për kategorinë e subjekteve të të dhënave “Patient”:**
 - Verifikimi i mbledhjes dhe i përpunimit të të dhënave personale, bazuar në nenet 5, 6, 7, 8 dhe 9 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Udhëzimit të Komisionerit Nr. 5, datë 26.05.2010 “Rregullat themelore në lidhje mbrojtjen e të dhënave personale në seksionin e kujdesit shëndetësor”, si dhe Vendimit të Komisionerit Nr. 2, datë 10.03.2010 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të regjistrimit të të dhënave, të hedhjes së të dhënave, të përpunimit dhe nxjerrjes së tyre”, në lidhje me:
 - Qëllimin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të njoftuar: Shëndetësi;
 - Verifikimin nëse të dhënat e kategorisë “Patient” përpunohen vetëm për qëllim “Shërbimi shëndetësor” apo edhe për qëllime të tjera;
 - Verifikim i Kategorive të të dhënave që përpunohen;

- Mënyrat e mbledhjes, regjistrimit, përpunimit, përhapjes dhe transferimit të të dhënave;
- Mjaftueshmërinë dhe proporcionalitetin e përpunimit të këtyre të dhënave përkundrejt qëllimit;
- Saktësinë dhe përditësimin e të dhënave personale që përpunohen;
- Kohën e ruajtjes së të dhënave personale që përpunohen;
- Përhapjen e të dhënave personale të mbledhura e të përpunuara, tek të tretët;
- Transferimin ndërkombëtar të këtyre të dhënave;
- **Ezaurimi i të drejtave të subjekteve të të dhënave “Pacient”, bazuar në nenet 6/a (Pëlqimi) dhe 18 (Detyrimi për informim), të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, në lidhje me:**
 - Informimin e subjekteve të të dhënave që ju mblidhen dhe ju përpunohen të dhënat personale dhe marrja e “pëlqimit”;
 - Rastet, nëse kontrolluesit i është kërkuar nga subjekti i të dhënave përmbushja e të drejtës për akses në përpunimin e të dhënave personale, si dhe nëse është kërkuar korrigjimi ose fshirja e këtyre të dhënave.

Siguria dhe politikat e privatësisë për përpunimin e të dhënave personale, bazuar në nenet 20, 27 dhe 28 të Ligjin Nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, si dhe bazuar në **Udhëzimin Nr. 5 për “Rregullat Themelore në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor”**

- Caktimin e ndonjë përpunuesi të të dhënave personale dhe mbi çfarë akti ligjor;
- Vendosjen e kontrollit në aksesin e të dhënave personale të përpunuara dhe përgjegjësitë në administrimin e këtyre të dhënave;
- Nivelin e sigurisë fizike dhe teknike të sistemit të përgjithshëm ose të veçantë për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale;
- Verifikimin, nëse ka në fuqi ndonjë rregullore të veçantë për mbrojtjen e të dhënave personale ose të ketë rregulla që janë përfshirë në rregulloren e brendshme;
- Verifikimin, nëse janë parashikuar dhe zbatohen politikat e mbrojtjes së të dhënave nëpërmjet “konfidencialitetit”.

Komisioneri Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi procesverbalin e inspektimit administrativ të mbajtur me këtë rast, si dhe provat e administruara vëren se:

1-Kontrolluesi, “Medical Clinic-Kristi” Korçë, nuk aplikon mekanizmin e “Pëlqimit”, i cili është një kusht i domosdoshëm në përpunimin e të dhënave personale. Ky mekanizëm nuk

aplikohej, as në rastin e mbledhjes të të dhënave të pacientëve dhe as në rastin e pranimit të punëmarrësve në punë. Kjo bie ndesh me, nenin 6, paragrafi 1, gërma "a", nenit 7, paragrafi 2, gërma "a", të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe me Udhezimin nr.5, datë 26.05.2010, për "Rregullat Themelore në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor", paragrafi 5, 6, 7 të tij. Për pasojë, dhe neni 18 i Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "Detyrimi për informim", nuk ka gjetur zbatim.

2- Kontrolluesi, "Medical Clinic-Kristi" Korçë, nuk ka të hartuar një rregullore të shkruar për mbrojtjen e të dhënave personale, në zbatim të nenit 27/2 "c" të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" : *"udhëzon operatorët pa përjashtim për detyrimet që kanë ne përputhje me këtë ligj dhe rregulloret e brendshme për mbrojtjen e të dhënave, përfshirë dhe rregullat për sigurinë e të dhënave"*.

3- Kontrolluesi, "Medical Clinic-Kristi" Korçë, nuk ka një kontratë me specialistin IT të jashtëm që ka instaluar dhe mirëmban sistemin elektronik të të dhënave, dhe për pasojë nuk ka si të ketë parashikuar të drejtat dhe detyrimet që palët kanë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe sidomos atë të pacientëve, të dhënat e të cilëve janë në kushtet e të dhënave sensitive.

Kontrolluesi nuk ka të dokumentuar marrjen e masave teknike dhe organizative për përpunimin e të dhënave personale dhe kjo çënon rëndë sigurinë e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, duke rënë ndesh me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" (i amenduar), neni 20, 27 pika 1, 2 (c, ë), 2.1 dhe neni 28.

Nisur sa më sipër në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe 107-109 të K.Pr.Administrative ;

REKOMANDOJ

1-Kontrolluesi, Klinika –Mjekësore "Kristi", Korçë në zbatim të nenit 27/2 "c" dhe neni 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të hartojë rregullore të brendshme për mbrojtjen e të dhënave personale, ku të përfshihet siguria e të dhënave dhe konfidencialiteti. Për hartimin e këtij akti, Zyra e Komisionerit ofron asistencën e saj.

2-Kontrolluesi, Klinika –Mjekësore "Kristi", Korçë në zbatim të nenit 20 dhe 27/1, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", të lidhë një kontratë me kompaninë apo individin që ka instaluar dhe mirëmban sistemin e të dhënave në rrugë elektronike, ku të parashikohen të drejtat dhe detyrimet që palët kanë, në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e konfidencialitetit.

3-Kontrolluesi, Klinika –Mjekësore "Kristi", Korçë në zbatim të nenit 6, paragrafi 1, gërma "a", neni 7, paragrafi 2, gërma "a", të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", si dhe në përputhje me Udhezimin nr.5, datë 26.05.2010, për "Rregullat

Themelore në lidhje me Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Sistemin e Kujdesit Shëndetësor", paragrafi 5, 6, 7 të tij, të konkretizojë në praktikat e veta të punës, dhe mekanizmin e "Pëlqimit".

Aplikimi i rubrikës së "Pëlqimit", do të passjellë detyrimisht dhe zbatimin e nenit 18, të Ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008, "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", "Detyrimi për informim".

4- Kryerja e këtij detyrimi të rëndësishëm që ju ngarkon ligji, të kryhet brenda një afati kohor prej 45 ditësh.

5- Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushjeje të këtij detyrimi, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 " Për mbrojtjen e të dhënave personale : "*Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të moszbatimit të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".*

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

KOMISIONERI

ELORA ÇABEJ (POGAÇE)

